

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 6 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe qytetarë,

Patjetër që do të përqendrohemi tek ato probleme vërtet shumë të mëdha, që bërtasin dhe ulërijnë te pragu i derës së çdo shqiptari, dhe nuk kam kohë për të humbur që të merrem me procesin e pusëtës septike të prodhimit të Presidentit, që duan ta aromatizojnë. Pusetat septike nuk aromatizohen dot, ato siç janë mbeten. Mëkat i madh është që përdorin emra njerëzish, që i njohën vonë dhe bëjnë sikur i adhurojnë. Do t'i përdorin siç janë të përdorur dhe vetë, por kjo është gjëja e fundit për të cilën qytetarët kanë interes.

Qytetarët duan të dinë, në mënyrë shumë të drejtpërdrejt, çfarë bëjnë këta këtu kur rriten çmimet? Pse Maqedonia, më e vogël se ne, pa oportunitetet tona, pa dalje në det, që nuk prodhon naftë jep paketa ndihme që shkojnë në 3,6% të PBB-së, kurse ne vetëm 0,3%? 12 herë më pak. Për këtë të kthejnë përgjigje. 12 herë më pak se Maqedonia. Çfarë ka më shumë? Nuk ka këta, kjo është diferenca, por të kishte këta, nuk do të ta kishte 0,3%, por 0,1% ose zero fare. Qytetarët duan të dëgjojnë pse shqiptarët, bashkatdhetarët tanë në kufi me Maqedoninë, gëzojnë që janë në kufi me të? Se atë karburantin e blejnë 1800 lekë, kur këtu është 2500 lekë; se bordi i kusarisë ndan pazarin, që e keni parë, e imponojnë 2500 lekë. Të tjetër e mbajnë edhe më poshtë, se është pazari i atyre që kontrollojnë tregun.

Shqiptarët e mbajnë në kurriz gjithmonë, këta vetëm duartrokin. Po çfarë kanë këta? Këta thonë “Ranë zjarret. Në të gjithë botën bien zjarre. Shikoni, bien zjarre edhe andej”; përmytjet: “Në të gjithë botën përmyten”, bie dëborë dhe bllokohen rrugët: “Në të gjithë botën ndodh”. Por kur bie zjarr ajo bota ngre helikopterë, i vesh njerëzit që të mos përvëlohen, nuk i lë ashtu lakuriq me nga një lopatë në dorë. Ah, për këtë nuk jemi si e gjithë bota! Na kanë thënë ca specialistë se është më mirë të punojnë me lopatë dhe janë të marrë ata europianë që

përdorin mjetet e tjera, që i ruajnë njerëzit të mos përvëlohen e përdorin teknologji!
Emergjencë e madhe! 4 helikopterë të bekuar, që janë të një niveli të lartë, ka Shqipëria!

Kanë para këta për 20 milionë euro kilometrin, kanë para të rrëmbejnë me qindra milionë euro për inceneratorët! Të tërë helikopterët janë “xhenaze”, asnjëri nuk është punë. Ky ishte halli! Ku është flota ajrore e Shqipërisë?! S’kanë ndër mend të flasin për helikopterët e t’i rregullojnë, por do t’i kthejnë përgjigje opozitës e do t’i thonë: “Ju pushoni; ju mos flisni; ju nuk keni të drejtë, se në kohën tuaj, atëherë, është bërë kjo punë!” Kanë kaluar 9 vjet e po bëhen 10. “Nuk ka rëndësi se çfarë kemi bërë, nuk ekziston kjo, por ju mos flisni!”. Ore, po digjet vendi! “Vetëm ju mos flisni, le të digjet vendi!”. U përmyt Shqipëria. “Ju mos flisni!”.

Kur përmytej Shqipëria e bënin gojën çorap kur ishin në opozitë (po kryetari i tyre, një llafazan profesionist): “Nuk janë punët e Zotit, janë punët e qeverisë”. Kur jua vendos përpara fillojnë e qeshin si karagjozë, por bëhen shumë të egër kur duan të marrin para borxh, deri në 2 miliardë e 600 milionë euro, që nuk ua kemi parë dukun dhe hairin në asnjë gjë! E marrin me zë të trashë atë! Kur ju thua që nuk marrin borxh kaq shumë në botë, që nuk bën njeri kaq shumë koncesione në botë, thonë: “Doni të na pengoni”, ndërsa kur bie borë dhe ndodhin edhe përmytje thonë që kjo ndodh në të gjithë botën. Këtë lloj halabakërie shtetërore, që nuk ka të bëjë hiç me shtetin, sigurisht që të gjithë e kuptojnë dhe nuk ka ndonjë vështirësi për të ndarë që paaftësia dhe të qenit grabitqar janë bërë bashkë.

Problemet janë aty. Kur nuk dominuan dot një sipërfaqe aq të ngushtë, aq të kontrolluar, siç është Sazani, në të gjithë duhet të mbajmë sytë nga qielli, të ruhemi e të lutemi pa u lodhur, që inshallah nuk bën i nxehtë i madh, se pastaj, si në “çdo vend të botës që digjet”, do të na thonë: “Digjuni rehat!” e do të na bëjë ndonjë postim në Facebook ky Kryeministri i tyre, që i quan kova me ujë biblik ato që përdorin të gjithë helikopterët anembanë botës kur ka zjarre të mëdha! Ky ironizon dhe thotë që është ujë biblik, se ky thotë që lëri të digjen! Kur thotë që lëri të digjen, ka një qëllim tjetër ndër mend, se atij që i dhemb për vendin e tij, për pronën, nuk do ta zinte vendi dhe do të thoshte: “Asnjë metër të mos digjet; ta shpëtoj dhe metrin e fundit”, por jo, thotë “ujë biblik”.

E lëmë idiotësinë intelektuale që përdor në rastin konkret, se është noterike kjo punë, e ditur për të gjithë këta, që të mos i marrim me radhë, se kanë xhevahire të mëdha! Atje digjet vendi e këta bëjnë humore të tilla?! Nuk kanë asnjë element gatishmërie, por monitorojnë e sodisin nga ajri, vështrojnë nga lart se si digjet; bëjnë foto, i hedhin në Facebook, bëjnë selfie. Kjo është qeverisja! Qeverisja nuk do selfie, nuk do dëngla propagande, nuk do merakun që t'i mbyllim gojën opozitës, por do veprime konkrete dhe puna flet vetë. Ajo e djegura, zi, qymyr lë nga mbrapa. Qymyri i zi është dhe ua nxin fytyrën, çfarëdo që të thonë, duan apo nuk duan, u pëlqen apo nuk u pëlqen!

Këto janë të vërtetat e mëdha dhe e vërteta e madhe është që këtu, në këtë parlament, çdo nismë e opozitës bllokohet; dy nismat e rëndësishme qoftë për çmimin e naftës, qoftë për ndryshimet në Kodin Penal, të imponuara nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, bllokohen. Kjo sallë është kthyer në një pronë të fëlliqur të kësaj maxhorance. Prandaj është shuar zëri i çdo diskutimi dhe prandaj kanë frikë të tmerrshme nga çdo fjalë, kritikë e koment. Faleminderit!